

Vendim nr. 161, datë 21.05.2026

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sonila Bejtja, Anëtarë në datën 21.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (T) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES:	TARIKATI ISLAMIK HALVETIAN , përfaqësuar nga avokatët Aleksandër Muskaj dhe Aleksia Aliu, me prokurë.
OBJEKTI:	Shfuqizimi i vendimeve nr. 10448, datë 31.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1295, datë 26.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-1144 (136), datë 20.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
BAZA LIGJORE:	Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (<i>Kushtetuta</i>); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (<i>Ligji Organik i Gjykatës</i>).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) pranë Bashkisë së Tiranës, me vendimet nr. 459, datë 21.02.1996 (*vendimi nr. 459/1996*) dhe nr. 345, datë 24.09.2000 (*vendimi nr. 345/2000*) e ka njohur Komunitetin Mysliman të Shqipërisë (KMSH) si ish-pronar të pasurisë me sipërfaqe 3534 m², duke vendosur: a) kthimin në natyrë të një pjese të saj (truall i lirë me sipërfaqe 768 m² me sipërfaqe funksionale e ndërtesa); b) kompensimin për pjesën tjetër për sipërfaqen 2774 m²; c) njohjen e së drejtës së parablerjes për truallin e zënë nga Dhoma e Tregtisë.

2. Me vendimin nr. 1, datë 11.01.2008, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë (AKKP-ja, Tiranë) për sipërfaqen e zënë 2265 m² (të njohur me vendimin nr. 345/2000) ka vendosur kompensimin fizik me një sipërfaqe 1185 m² truall, duke i konsideruar të ekzekutuara vendimet e mëparshme të njohjes të së drejtës. Në zbatim të këtij vendimi, pasuria është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të KMSH-së.

3. Më pas, me vendimin nr. 444, datë 02.09.2009, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 345/2000 dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim. Ky akt është kundërshtuar në rrugë gjyqësore nga KMSH-ja.

4. Pavarësisht për sa më sipër, me vendimin nr. 706, datë 10.11.2009 (*vendimi nr. 706/2009*), AKKP-ja e ka deklaruar të pavlefshëm vendimin nr. 1, datë 11.01.2008, me të cilin ishte realizuar kompensimi fizik në favor të KMSH-së. Si pasojë e këtij vendimi, pasuria e regjistruar në emër të KMSH-së ka kaluar në regjistrat publikë në emër të shtetit.

5. KMSH-ja ka pretenduar se nuk ka pasur dijeni për ekzistencën e vendimit nr. 706/2009 të AKKP-së dhe se është vënë në dijeni për këtë akt në vitin 2014, gjatë procedurave administrative për marrjen e dokumentacionit të pronësisë. Në këto rrethana, KMSH-ja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar: i) anulimin e vendimit nr. 706/2009; ii) fshirjen e regjistrimit të tij në regjistrat e pasurive të paluajtshme; iii) rivendosjen e gjendjes juridike të mëparshme.

6. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 10448, datë 31.10.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke vendosur anulimin e aktit të kundërshtuar dhe fshirjen e regjistrimit përkatës. Pas ankimit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1295, datë 26.05.2015, ka vendosur lënien të fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

7. Ndaj vendimit ka ushtruar rekurs AKKP-ja, Tiranë dhe Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1144 (136), datë 20.03.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1295, datë 26.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se

përfundimi i gjykatës së apelit për shkeljen e nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC) nga ana e Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ish-AKKP-ja) në dhënien e vendimit objekt kundërshtimi është rrjedhojë e mungesës së arsytimit për ekzistencën e elementeve të “gjësë së gjykuar” të çështjes së kompensimit fizik të sipërfaqeve të njohura për t’u kompensuar me vendimet nr. 459/1996 dhe nr. 345/2000 të KKKP-së. Sipas Gjykatës së Lartë, nga gjykata e apelit nuk është argumentuar se përse vlefshmëria ose ligjshmëria e vendimit nr. 1, datë 11.01.2008 të ish-drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë në lidhje me kompensimin fizik të sipërfaqeve të njohura sipas neneve 11, 12 dhe 16/1 të ligjit nr. 9235/2004 përbën “gjë të gjykuar”, në një kohë që ky vendim nuk ka qenë objekt shqyrtimi ose vlerësimi më parë në referim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të marra si prova gjatë këtij gjykimi. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykata e apelit, duhet të përsërisë hetimin gjyqësor për t’iu dhënë përgjigje pretendimeve të palëve, duke i analizuar këto në raport me provat e paraqitura dhe të lejuara në gjykim.

8. Ndërkohë, kërkuesi, i cili përfaqëson një komunitet fetar islamik dhe ka pretenduar të drejta pronësie mbi të njëjtat prona, që i janë njohur e kthyer KMSH-së, në datën 18.06.2014 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke paditur KMSH-në me kërkesëpadi, me objekt ndryshimin e vendimit nr. 345/2000 të KKKP-së pranë Bashkisë së Tiranës, duke e detyruar KMSH-në për ta njohur si pronar dhe fshirjen e të drejtave reale në favor të KMSH-së dhe regjistrimin e vendimit në favor të kërkuesit. Me vendimin nr. 9744, datë 09.10.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj e në prova. Pas ankimit të kërkuesit, me vendimin nr.1366, datë 02.06.2015, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 9744, datë 09.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si vijon: 1. Ndryshimin e vendimit nr.345, datë 24.09.2000 të KKKP-së që ka njohur KMSH-në si ish-pronar të kësaj prone. 2. Detyrimin për të njohur kërkuesin pronar për truellin objekt gjykimi të njohur me vendimin nr. 345/2000 të KKKP-së, si dhe të gjitha të drejtat e pronësisë, të parablerjes dhe të kompensimit fizik që burojnë nga vendimi nr.1, datë 11.10.2008 i AKKP-së Tiranë. 3. Fshirjen e të drejtave të pronësisë dhe të të drejtave të tjera reale të KMSH-së të fituara me vendimin nr. 345/2000 të KKKP-së dhe regjistrimin e këtij vendimi në favor të kërkuesit. Pas rekursit të ushtruar nga KMSH-ja, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2016-2979, datë 21.11.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit. Në vitin 2017 KMSH-ja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë, me objekt kundërshtimin e vendimeve nr. 1366, datë 02.06.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2016-2979, datë 21.11.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës

së Lartë. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 100, datë 05.05.2017, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi pretendimet ishin haptazi të pabazuara.

9. Në rastin konkret, kërkuesi, në datën 11.02.2026, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës me ankimin kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimin nr. 00-2024-1144 (136), datë 20.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, proces gjyqësor i nisur për kërkesëpadinë e KMSH-së (*shih paragrafin 5 të vendimit*). Kolegji i Gjykatës në datën 24.04.2026, gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, ka vendosur kalimin e saj për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

10. Në datën 19.05.2026 një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 21.05.2026, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vlerësuar se gjyqtari gjendej përpara rastit të parashikuar në nenin 36, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 18, pika 1, shkronja “a”, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

II

Pretendimet e kërkuetit

11. **Kërkueti**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor i janë cenuar:

11.1. *E drejta e pronës*, e garantuar në nenin 41 të Kushtetutës, pasi kërkueti ka fituar të drejtën e pronës me vendim gjyqësor të formës së prerë. Parimisht, procesi gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i shtrin efektet juridike vetëm ndaj palëve që janë pjesë e mosmarrëveshjes juridike. Megjithatë, juridiksioni kushtetues legjitimon edhe subjekte të tjera për t’iu drejtuar Gjykatës kur preken drejtpërdrejt nga efektet juridike të një vendimi përfundimtar. Në këtë kuptim, kërkueti, edhe pse nuk ka qenë palë në procesin gjyqësor, është cenuar drejtpërdrejt në të drejtën e pronës nga ato vendime.

11.2. *Parimi i res judicata*, pasi edhe sikur kërkueti të priste përfundimin e rigjykimit në gjykatën e apelit, pasojat e cenimit nuk do të shuheshin, sepse procesi gjyqësor objekt kundërshtimi ka cenuar *parimet e sigurisë juridike dhe res judicata*, duke vënë në diskutim të drejtën e pronësisë së kërkuetit. Vendimet gjyqësore kanë krijuar një situatë ku e drejta e pronësisë nuk është më e sigurt, e parashikueshme dhe e mbrojtur.

11.3. *E drejta për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës*, pasi kërkueti nuk ka pasur mundësi reale dhe efektive për t’u dëgjuar

dhe mbrojtur interesat e tij. Një proces nuk mund të konsiderohet i rregullt kur një subjekt përballlet me pasoja të rënda juridike, si humbja e së drejtës, pa qenë realisht palë në procesin që i ka sjellë pasoja.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimimin e kërkesit

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë, si pasojë, moskalimin e saj në seancë plenare.

14. Në çështjen konkrete, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon të ndalet në analizën e kriterëve të legjitimitetit *ratione personae* dhe *shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion*. Për legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, individi mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 33, datë 20.05.2025; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Ndërsa për shterimin e mjeteve juridike efektive në dispozicion, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga

kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor civil me palë paditëse KMSH-në, palë të paditura Agjencinë e Trajtimin të Pronave (ish-Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë), Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë (ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë), Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe të Inovacionit (ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes) dhe se kërkuesi nuk rezulton të ketë qenë palë në atë proces.

17. Për sa i përket analizës së këtyre dy kritereve, Mbledhja e Gjyqtarëve, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas neneve 31/a, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 11 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

18. Sipas njërit qëndrim, bazuar në aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, konstatohet qartësisht që kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna gjatë një procesi gjyqësor, në të cilin nuk ka qenë palë. Lidhur me aspektin procedural të kriterit *ratione personae*, bazuar edhe në dispozitat e KPC-së (nenet 6 e vijues) parashikohet se gjykata e juridiksionit të zakonshëm shprehet vetëm për atë që kërkohet nga palët, mbi faktet e paraqitura gjatë procesit gjyqësor. Gjithashtu, mjetet e ankimit ndaj vendimeve të gjykatave të zakonshme mund t'i ushtrojnë palët ose pjesëmarrësit e tjerë në procesin gjyqësor (nenet 442 e vijues të KPC-së) dhe se vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, personat që heqin të drejta nga palët dhe gjykatat (neni 451/a i KPC-së). Në këtë kuptim, në kushtet kur objekt kundërshtimi janë vendime gjyqësore të dhëna në një proces ku kërkuesi nuk ka qenë palë/pjesëmarrës në proces ai nuk mund të legjitimohet *ratione personae*. Gjithashtu, edhe në drejtim të shterimit të mjeteve juridike, kërkuesi nuk ka provuar përpara Gjykatës se nuk ka mjete të tjera në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës së pretenduar të cenuar nga procesi gjyqësor. Në këto rrethana, edhe nëse nga procesi gjyqësor i kundërshtuar kërkuesit i është cenuar ndonjë e drejtë kushtetuese substanciale (sikurse është e drejta e

pronës), ai duhet të përdorë mjetet juridike në dispozicion dhe vetëm pas përdorimit të tyre mund t'i drejtohet Gjykatës, pasi mbrojtja kushtetuese ka natyrë subsidiare¹.

19. Sipas qëndrimit tjetër, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi edhe pse nuk ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar në këtë Gjykatë (aspekti procedural), ai legjitimohet në aspektin substancial, për sa kohë që interesat e tij preken nga vendimet e kundërshtuara me këtë ankim kushtetues individual, me të cilat është disponuar për pasurinë që e ka fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë, pra përbën *res judicata*. Në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, në kundërshtim me qasjen tjetër, kërkuesi nuk kishte mundësi të ishte pjesë e procesit gjyqësor, për sa kohë që nuk ishte njoftuar nga asnjë prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për rrjedhojë, në momentin që ai (kërkuesi) nuk është njoftuar për procesin gjyqësor objekt kundërshtimi, si bartës i së drejtës së pronësisë me vendim gjyqësor të formës së prerë, atij nuk i është krijuar mundësia për të qenë palë në proces, për pasojë nuk ka pasur mundësi të shterojë edhe mjetet juridike efektive në dispozicion. Për më tepër, Gjykata nuk mund të jetë në rolin e orientueses ndaj palës, duke i treguar cilin mjet juridik mund të përdorë, por duhet të arsyetojë vetëm në lidhje me plotësimin e kriterëve të pranueshmërisë së kërkesës².

20. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Mbledhja e Gjyqtarëve konstatoi se nuk ishte e mundur të formohej shumica e gjyqtarëve, sipas parashikimit të neneve 31/a, pika 1, dhe 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës për të vijuar me shqyrtimin dhe vendimmarrjen për kriteret e tjera për pranueshmërinë e kërkesës.

21. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31/a, pika 1, dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 11 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

¹ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Marjana Semini.

² Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahim.